



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-02/04-130558/18, më 31.05.2018

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 3, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 16/2017 vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e ekipit vlerësues pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta, për t'ju mundësuar arsimim të përshtatshëm bazuar në nevojat individuale të tyre.
- II. Ekipi vlerësues pedagogjik është në këtë përbërje:
 1. Liridona Krasniqi - Preniqi, Drejtorja e Arsimit;
 2. Taibe Morina, psikologe, SHFMU "Hilmi Rakovica", SHFMU "Meto Bajraktari";
 3. Miranda Islamaj, mësuese mbështetëse, SHFMU "Naim Frashëri";
 4. Lirije Vitia, pedagoge speciale, Q.B "Përparimi";
 5. Mevlan Hyseni, punëtor social, QPS.
- III. Detyrat dhe punët e ekipit vlerësues pedagogjik janë të përsaktuara në Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 16/2017 vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Drejtorisë së Arsimit;
- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Sipend Ahmeti